



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 24-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 18. 12. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Adelina Krasniqi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Lulzim Rrustemi, anëtar
18. Nazmi Krasniqi, anëtar
19. Enver Kozhani, anëtar
20. Feriz Hasani, anëtar
21. Ali Stublla, anëtar
22. Valbona Shillova, anëtar
23. Burbuqe Ilazi, anëtar
24. Vlora Buja, anëtar
25. Arben Bahtiri, anëtar
26. Edita Gashi, anëtar
27. Ramiz Qeriqi, anëtar
28. Zoran Çirkovic, anëtar
29. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
3. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit

4. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
5. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
6. Feti Krasniqi, Drejtor i BPZHR
7. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
8. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
9. Avni Olluri, Drejtor i DGJK
10. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
11. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
12. Vlora Krasniqi, shefe e zyres ligjore
13. Lumnije Ejupi, Shefe e sektorit pronoro juridik
14. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
15. Bekim Krasniqi, "YAHR"
16. Përfaqësues të OJQ "POLIS" (3)
17. Bukurije Zejnullahu, zyra për informim
18. Përfaqësuesit e mediave
19. Numër i konsideruar i qytetarëve
20. Naser Bytyqi, perkthyes shqip-serbisht
21. Bajram Zaskoku
22. Bestar Ibrahim, operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Sami Murati.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marr dhe të njejtin e lexoi në vazhdim e gjithashtu e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për të anëtarëve prezent për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të e KK-së
2. Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave të territorin e Komunës së Lipjanit
3. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës së Lipjanit, "BETONI- & MB" SH.P.K.
4. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës së Lipjanit , N.T.SH "AL-TEC".
5. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit distributiv në fshatin Krojmir.
6. Propozim Vendim për shkëputjen e kontratës 1nr.464-164 të dt.01.08.2006 e lidhur ndërmjet komunës së Lipjanit dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore SH.P.K "BEN-AF" me seli në Suharekë
7. Propozim Vendim për shkëputjen e kontratës 1nr.463-322 të dt.04.10.2007 e lidhur ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore qendra medicinale "INTERMED" SH.P.K Lipjan
8. Propozim Vendim për anulimin e Vendimit të Kuvendit komunal Nr.464-264 të datës 23.03.2009 dhe shkëputjen e kontratës së datës 18.09.2009 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës në ZK Banullë -pasuri shoqërore e KK Lipjan, fondacionit të dijanetit të turqisë-institucionet shëndetësore 29 maji

9. Propozim Vendim për pagesën e meditimeve të Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi pyeti anëtarët se a ka dikush të shtroj diqka.

Blerim Gashi, kërkoj që në të ardhmen Rregullorja mbi taksat të plotësohet dhe në të të përfshihen disa veprimtari ekonomike të cilat përfitojnë shumë dhe fare nuk paguajnë taksa si shembull po e marr Bankat por ka edhe biznese tjeta. Çështje tjetër është që te pusët e ujit në Lipjan ka shperthyer kanalizimi dhe pyes se a do të rregullohet a jo.

Burbuqe Ilazi, pyeti se sa të hyra ka pasur Komuna prej shtëpisë së kulturës dhe tregjet.

Hajrije Salihu, pyeti se a ka pasur konkurs në shtëpinë korrektuese për pranimin e disa kuadrove.

Feriz Hasani, kompania Kastrioti është vendos në pronën e Komunës dhe pyes se a është duke i paguar taksë komunës për pronën që po e shfrytëzon.

Ramiz Qeriqi, për kompanin që përmendi Ferizi ai nuk ka leje për aty dhe disa mjete nuk janë të tij dhe qytetarët kanë nënshkru një peticion për largimin e kësaj kompanie meqë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj kundërmon një erë e rëndë që është e padurueshme për ata qytetarë dhe deri në janar ajo kompani duhet të largohet nga aty.

Ali Stublla, ajo kompani është duke punuar ilegalisht dhe nuk ka kurrfarë leje dhe sa më parë duhet t'i ndërprehet puna.

Merita Zeqiri-Hajrizi, pyeti pse nuk po kryhet rrethoja në shkollën tonë dhe propozoj që sa më parë të ndahet shkolla nga parku me rrethojë.

Rasim Hasani, sa i përket shkollës në qendrën e paraburgimit unë ju them se edhe Ligji nuk i paraqet disa qështje. Në një shkresë të MASHT-it thuhet se i lejohet shkollës "Ismajl Luma" dhe "Vllëzërit Frashëri" që të hapë një paralele për mësim në qendrën e paraburgimit dhe tani është organizu mësimi atje dhe kemi angazhu disa punëtor tonë edhe pse Ministria nuk i paguan. Sa u përket rrethojës së shkollës ai oborr është i shkollës dhe derisa Kuvendi nuk merr vendim me e nda parkin na nuk mundemi me e bërë rrethojën.

Heset Sahiti, gjatë ndërtimeve të objekteve dikush ujrë atmosferike i ka futur në kanalizim fekal dhe gjatë reshjeve atmosferike rritet sasia e ujit dhe kanalizimi del në sipërfaqe, mirëpo për këtë besoj se do të intervenojmë patjetër.

Latif Ramadani, për përfshirjen e disa bizneseve për pagim të taksave unë ju them se Rregulloren e kemi punuar në bazë të Ligjit dhe nëse ndryshon Ligji edhe na e ndryshojmë Rregulloren.

Blerim Gashi, unë nuk pajtohem me Drejtorin për Rregulloren që e arsyetoi.

Merita Zeqiri- Hajrizi, pavarësisht se parku është oborr i shkollës dhe aty po ndodhin probleme në mes të rriturve që shetisin në park dhe nxënësve, andaj kërkoj që të bëhet rrethoja.

Florent Hoxha, unë e di që për rregullimin e parkut është marrë Vendim nga Shërbimi Pronësoresh Juridik se siqë e dijmë të gjithë aty ka pasur objekte që kanë qenë degjeneruese dhe mendoj se ai Vendim mund të shërbej për ndarjen e oborrit të shkollës.

Në vazhdim pyeti se me qfarë Vendimi është ndarë oborri për ndërtimin e shkollës në Glllogovc.

Pasi pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Kuvendit?

Pastaj vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Rregullore për menaxhimin e mbeturinave të territorin e Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Heset Sahitit Drejtor i DSHP, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, unë edhe më herët kam bisedu me Drejtorin e Sherbimeve Publike për nxjerrjen e kësaj Rregullore dhe si grup parlamentar i LDK-së na e përkrahim këtë Rregullore.

Florent Hoxha, edhe na si grup parlamentar i PDK-se e kemi shqyrtuar këtë propozim Rregullore dhe kjo Rregullore është vonuar. Në vazhdim tha se përveq Ligjit janë edhe disa udhëzime administrative që duhet të plotësohet kjo Rregullore dhe ne propozojmë plotësimet si vijon:

Te neni 4 të plotësohet dhe të thuhet: plani i menagjimit të mbeturinave të jetë në pajtim me planin e nivelit qëndror.

Te neni 4 pika 3 propozojmë që bizneset përveq mirëmbajtjes para objekteve të tyre të parashihet që të mirëmbajë edhe hapsirat për rreth tyre.

Te neni 4 të shtohet një paragraf i ri dhe të parashihet edukimi dhe trajnimi i nxënësve për mirëmbajtjen e mbeturinave si dhe hudhjen e tyre.

Kur thuhet plani i menaxhimit të mbeturinave të thuhet plani i Komunës për menaxhimin e mbeturinave.

Te orari i bartjes dhe grumbullimi i mbeturinave të caktohet prej orës 22 deri në ora 5 në mëngjes.

Përveq masave të parapara duhet të parashihet edhe masa e ndalimit të hedhjes së mbeturinave.

Denimet e parapara prej 5-100 euro këto janë gjoba për kundërvajtje.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, kërkoj nga anëtarët që t'i përmbahen Rregullores së Punës së Kuvendit dhe propozimet që i dhat ju Florent nuk janë në rregull meqë këto propozime është dashtë të ipen në Komision edhe në KPF në mënyrë që sot të kishim një rekomandim nga Komiteti për ta plotësuar këtë Rregullore, kurse në formën që po i propozoni ju sot nuk kemi mundësi me i përfshi.

Florent Hoxha, është e vërtetë që na kemi dhënë vërejtjet por nuk i kemi paraqitë me shkrim por konsideroj se si anëtarë të Kuvendit kemi të drejtë t'i propozojmë plotësimet dhe Drejtori është këtu e gjithashtu edhe Komisioni dhe nëse propozimet tona janë me vend atëherë duhet të mirren dhe plotësohet Rregullorja.

Blerim Gashi, është një fushë e veprimtarisë komunale shumë e rëndësishme dhe konsideroj se ka mundësi me i dhënë propozimet për ndryshime dhe plotësime dhe nëse nuk

mund t'i bëjmë sot bënë edhe mu shty kjo Rregullore për mbledhjen e ardhshme. Caktimi apo ndarja e mbeturinave nuk janë në harmoni me Ligjin sipas kësaj Rregullore, andaj propozoj që kjo Rregullore të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Heset Sahiti, unë po e shpreh besimin e Komisionit i cili ka nxjerr komplet obligimet që ka Komuna për menagjimin e mbeturinave dhe nuk po them se nuk ka vend për plotësim të kësaj Rregullore. Pajtohem me propozimin e Florentit ku thotë që të plotësohet neni 4 dhe të thuhet plani komunal i menagjimit të mbeturinave të harmonizohet me planin e nivelit qëndrorë. Pastaj tha se kjo Rregullore shkon edhe në Ministrinë e APL-së dhe do të filtrohet dhe nëse Ministria konstaton se ka shkelje sigurisht do ta kthen për plotësim.

Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës, nuk dashta me diskutu por më nxiti fjala e Kryesueses dhe e Florentit se Kryesuesja u thirr në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe kërkoj që propozimet të vijnë me kohë sipas Rregullores së Kuvendit. Gjithashtu edhe Florenti ka të drejtë që propozon plotësimin e Rregullores dhe të gjitha propozimet ishin me vend.

Ukë Kryeziu, kjo Rregullore i ka munguar gjerë me tani Kuvendit dhe është mirë që është hartu dhe propozoj që të kapitulli 8 propozoj që të parashihet ndarja e mbeturinave, letër veq, plastikë veq, hekuri veq etj. Në fund propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të plotësohet me propozimet që u dhanë më herët.

Lulzim Rustemi, para se të bihet për shqyrtim kjo Rregullore është dashtë të mbahet një takim me të gjitha grupet e interesit dhe të diskutojnë për këto qështje në mënyrë që Rregullorja të rrumbullaksohet në tërësi. Unë i di vështërsitë e Kryesueses se kam qenë vetë Kryesues dhe nuk ka mundësi që të gjitha propozimet që u dhanë të përfshihen sot në këtë Rregullore, andaj propozoj që kjo Rregullore të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, në bazë të propozimeve që u dhanë nuk ka mundësi që t'i përfshi të gjitha sot në Rregullore meqë nuk jam juriste.

Vlora Krasniqi, në Rregullore i kemi parapa të gjitha ato qështje që janë në kopetencë të Komunës që i parasheh Ligji dhe nuk ka nevojë të gjitha ato që janë në Ligj të hyjnë në Rregullore.

Labinot Shahini, kemi ardhë në dy qështje ta aprovojmë Rregulloren siqë është propozu apo ta shtyjme meqë sot nuk kemi mundësi t'i përfshijmë të gjitha propozimet e gjithashtu tha se materiali është dërgu qe 10 ditë dhe askush nuk ka paraqit me shkrim vërejtje dhe faji për këtë është i asambleistëve.

Ramiz Qeriqi, kërkoj që disa kategori që nuk kanë mundësi të paguaj të lirohen nga pagesa.

Arben Bahtiri, nëse ne nuk i edukojmë fëmijët se ku duhet të hudhen mbeturinat kot e kemi të aprovojmë Rregulloren. Pastaj tha se përgjatë rrugës Lipjan-Magurë hudhen mbeturina të ngurta dhe askush nuk ka marr masa.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, sipas diskutimeve dhe propozimeve të shefave të grupeve parlamentare po shihet se kjo Rregullore duhet të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, andaj propozoj që Komisioni të merr inqizimin e mbledhjes së Kuvendit dhe këtë Rregullore ta plotësoj sipas propozimeve që u dhan më lartë. Në vazhdim pyeti anëtarët se kush është që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për 1 kundër, vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që Komisioni ta plotësoj me propozimet që u dhanë gjatë shqyrtimit.

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12⁰⁰ Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13⁰⁰

Pas pauzës në ora 13²⁵ Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së tretë.

III

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, “BETONI- & MB” SH.P.K.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK dhe Kryetar i Komisionit vlerësues i cili fillimisht njoftoi të pranishmit me procedurat e propozimit të Vendimit duke shtuar se kemi pas vetem një ankesë.

Pastaj njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit, duke lexuar të njejtin.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ramiz Qeriqi, qka na lidh neve dhe cili interes është i Komunës e gjithashtu a është bisedu me këtë firmë dhe a është serioze.

Linda Shahini, unë jam anëtare e Komisionit dhe të gjitha procedurat kanë shkuar në rregull, andaj kërko që të përkrahet ky propozim Vendim.

Florent Hoxha, shef i grupit parlamentar i PDK-së tha se kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e kundërshtojmë meqë në këto zona ku gjindet kjo pjesë e tokës nuk janë zona ekonomike apo industriale dhe nuk janë në harmonizim me planin zhvillimor që e ka aprovu ky Kuvend dhe kjo zonë është zonë e lignitit sipas planit zhvillimor dhe kjo hapsirë duhet të ruhet për lignitet meqë nesër ndoshta do të vijë ndonjë investitor. Na nuk jemi kundër ofertave por jemi kundër zonave ku janë caktu.

Lulzim Rrustemi, qdo Vendim që bie në kundërshtim me planin zhvillimor nuk mund të kaloj dhe ky plan zhvillimor është në fuqi deri në vitin 2023 dhe brenda 5 viteve nuk mund të ndryshohet, andaj na jemi kundër këtij Vendimi.

Xhevat Olluri, diskutuesit e mëparshëm ndoshta kanë të drejtë, por na e dijmë që ky Kuvend më heret ka vendos që kjo pronë me u dhënë në shfrytëzim, prandaj unë përshtatshëm dhe grupi parlamentar i subjektit tonë e përkrahim këtë propozim Vendim.

Avni Olluri, po i përgjigjem Luanit se përfitimi i Komunës është se kompania e merr lejen e ndërtimit dhe paguan taksën Komunës dhe i punëson 35 vetë. Pastaj tha se ky Vendim është plotësisht në harmonizim me Ligjin mbi shkëmbimin e pronave.

Florent Hoxha, na edhe kur është aprovu Vendimi paraprak për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim kemi qenë kundër atij Vendimi meqë është në kundërshtim me planin zhvillimor dhe nëse tani ky Vendim aprovohet ne do ta kundërshtojmë edhe në institucionet më të larta.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 8 kundër Kuvendi aprovoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET, oferta e përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. “BETONI - & MB “ SH.P.K, është shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Prona e paluajtshme e Komunës, gjindet në fshatin Babush i Muhagjerëve, Zona kadastrale Babush, me sipërfaqe prej **2.00,00 ha** (2 hektar) nga pjesët e parcelave

kadastrale nr.P-71409059-00555-0 dhe nr.P-71409059-00559-0, kullosë e klasës së 4 e evidentuar në çertifikatën nr.14-6302 dhe çertifikatën nr.14-6303.

3. Shfrytëzimi i pronës do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Në pronën e cekur do të ushtrohet veprimtaria : Fabrikë për prodhimin e gypave dhe elementeve tjera nga betoni.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Zyra e Kryetarit të Komunës - sektori pronesor- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit , N.T.SH “AL-TEC”.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK dhe Kryetar i Komisionit i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ali Stublla, në Vendim thuhet se shfrytëzues është AL-TEC dhe me sa e di unë nuk është shfrytëzues ende deri sa të aprovohet Vendimi, andaj kjo duhet të ndërrohet. Pastaj pyeti se si anëtarë të Komisionit a kemi të drejtë të prezantojmë kur nënshkruhet kontratë.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit, për pyetjen që bërë Alia se a kemi të drejtë të prezantojmë gjatë nënshkrimit të kontratës si anëtarë të Komisionit unë nuk e di si është e rregulluar me Ligj dhe duhet ta shiqojmë.

Linda Shahini, me qenë se kam qenë anëtare e Komisionit dhe kjo ofertë i përmbush të gjitha kriteret ligjore dhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Lulzim Rustemi, na e dham qëndrimin tonë lidhur me këto Vendime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin dhe nëse kalojnë ka me pasur lajthitje për investitorë.

Blerim Gashi, pyeti se vendimet paraprake a janë miratu nga MAPL dhe nëse janë miratu atëherë duhet të aprovohen edhe këto propozim vendime meqë me këtë kemi edhe një zhvillim lokal.

Ukë Kryeziu, duke marrë parasysh vendimet paraprake për dhënien në shfrytëzim që i ka aprovuar ky Kuvend ne i përkrahim edhe këto propozim vendime meqë pikërisht kanë të bëjnë me zhvillimin e Komunës tonë.

Florent Hoxha, unë e di se edhe niveli qëndror i ka shqyrtu vendimet paraprake dhe janë bazu në dispozitat ligjore që është mbështetur Komuna për këto vende por niveli qëndror nuk i kanë pasur parasysh planet e zhvillimit të Komunës e që këto vendime janë në kundërshtim me planin e zhvillimit të Komunës.

Arben Bahtiri, Drejtori tha se kjo është e vetmja fabrikë që ndërtohet në Kosovë, por unë e di se një fabrikë e tillë është ndërtu në Drenas ku ka investu Bashkimi Evropian.

Avni Olluri, nënshkrimi i kontratës do të jetë transparent, ndërsa i përket prezencës së anëtarëve së Komisionit gjatë nënshkrimit të kontratës do të konsultohemi me zyrën ligjore.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 8 kundër aprovoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË
LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET, oferta e përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

5. N.T.SH. "AL-TEC", është shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Prona e paluajtshme e Komunës, gjindet në fshatin Babush i Muhagjerëve, Zona kadastrale Babush, me sipërfaqe prej **1.00,00 ha** (1 hektar) nga pjesët e parcelave kadastrale nr.P-71409059-00555-0 dhe nr.P-71409059-00559-0, kullosë e klasës së 4 e evidentuar në çertifikatën nr.14-6302 dhe çertifikatën nr.14-6303.
7. Shfrytëzimi i pronës do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
8. Në pronën e cekur do të ushtrohet veprimtaria : Fabrikë për prodhimin e ushqimit të genëve dhe maceve.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Zyra e Kryetarit të Komunës - sektori pronesor-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: propozimi i Vendimit.

V

Propozim Vendim për dhënie në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit distributiv në fshatin Krojmir.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit, Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Enver Kozhani, ne si grup parlamentar i PDK-se e mbeshtesim këtë propozim Vendim.

Labinot Shahini, edhe me si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONIT DISTRIBUTIV NË FSHATIN KROJMI

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 99 vite toka-Pasuri Shoqërore KEDS-it sh.a Divizoni i shpërndarjes Prishtinë për vendosjen e TS-it me fuqi 160kVA të tipit Shtyllë-metalike me sipërfaqe prej 10m² në pjesën e ngastrës kadastrale: P-71409039-00519-0 në vendin e quajtur "Pojate Xhira" me kulturë kullosë e kl.2-të me sipërfaqe prej 1135m² e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme Nr.4648/15 ZK Krojmir, P.Sh. Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Prona e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, respektivisht sipërfaqja prej 10m² e nevojshme për vendosjen e TS-it me fuqi 160kVA i ipet në shfrytëzim për periudhën prej 99 viteve KEDS-it sh.a Divizoni i shpërndarjes Prishtinë, me qëllim të përmirësimit të rrjetit elektrik dhe furnizimit më të mirë me energji elektrike në fshatin Krojmir.

Neni 3

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas marrjes së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtoratin për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcelazimin e sipërfaqës e cila ipet në shfrytëzim dhe e njëjta të regjistrohët në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë për 99 vite Kompanisë KEDS.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për shkëputjen e kontratës 1nr.464-164 të dt. 01.08.2006 e lidhur ndërmjet komunës së lipjanit dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore SH.P.K "BEN-AF" me seli në Suharekë

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi duke shtuar se kemi një ndryshim në nenin 2 të Vendimit ku thuhet: " pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi kompania në afat prej 60 ditësh kalendarike të kthen ngastrën kadastrale në gjendjen e mëparshme.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ramiz Qeriqi, janë shumë firma që u kemi dhënë në shfrytëzim pronën për 99 vjet dhe së pari kemi fillu me këta që kanë punuar diqka kurse me ata që nuk kanë punuar fare nuk kemi fillu marrjen e pronës e që realisht është dashtë që së pari t`u mirren pronat atyre që nuk

kanë punuar fare e pastaj këtyre që kanë punuar, andaj propozoj që këtyre që kanë punuar t'u shtyhet afati edhe për 6 muaj.

Agron Hajdini, kemi të bëjmë me një Vendim të vitit 2006 ku "BEN-AF-i" e ka marrë pronën në shfrytëzim dhe nuk i ka përmbushë obligimet në bazë të kontratës e gjithashtu nuk e ka marrë lejen e ndërtimit dhe nuk e ka paguar taksën. Gjithashtu tha se unë pajtohem edhe me plotësimin e nenit 2.

Florent Hoxha, edhe na grupi parlamentar i PDK-se e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe sipas arsytimit të këtij Vendimi shihet se kontraktuesi nuk i ka përmbush obligimet e kontratës mirëpo na edhe në KPF kemi kërku që të paraqitet një raport për këtë zonë e gjithashtu edhe kostoja e investimeve që ka bërë investitori dhe ne nuk e dijmë a është bisedu me ta se ku janë arsyet që nuk janë realizu obligimet që dalin nga kontrata dhe na si grup parlamentar jemi kundër aprovimi të këtij Vendimi dhe kërkojmë që t'i ipet edhe një afat për përmbushjen e obligimeve nga kontrata.

Blerim Gashi, qe nëntë vite kjo pronë është dhënë në shfrytëzim dhe pronari ka investu në mënyrë ilegale dhe pyes Drejtorin se a është thirrë ky pronar ndonjëherë në bisedë e gjithashtu kërkoj të njoftohemi se a i kemi përmbush obligimet ndaj tij. Na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Ukë Kryeziu, me sa e di unë kjo është hera e dytë që po procedojmë me shkëputjen e kontratave dhe është mirë që kemi filluar këtë punë dhe jam ithëtar i asaj që të vazhdojmë edhe më tutje me shkëputjen e kontratave ndaj atyre që nuk i kanë përmbush obligimet.

Feriz Hasani, kjo është ajo që e ceka më herët për kompanin Kastrioti se ai qe 10 vite është vendos në mënyrë ilegale në pronën komunale.

Ali Stublla, në pjesën te ÇMI-ja janë dhënë shumë prona dhe pyes pse tani kemi fillu vetëm me Ben-afin i cili ka investu a të tjerë që kanë marrë pronën dhe fare nuk kanë investu e atyre nuk u merren pronat.

Xhevat Olluri, këtë kontratë Kryetari ka mund me e shkëputë edhe pa e pru në Kuvend. Unë e përkrahu këtë propozim Vendim meqë investitori nuk i ka përmbush obligimet sipas kontratës së nënshkruar.

Te neni 9.3 i kontratës thuhet se Komuna duhet ta rregulloj infrastrukturën unë nuk e di a ka ndodh kjo. Gjithashtu shtrohet pyetja se si mund të thuhet se objekti është ndërtu pa leje kur aty ka qenë prezent e gjithë struktura komunale.

Te neni 8.2 dhe 8.3 investitorit i ipet e drejta për transaksione dhe unë nuk e di se a është biseduar me investitorin që ky objekt t'i ipet dikujt tjetër me transaksion pa e ndërru destinacionin kuptohet me marrëveshje të Komunës.

Avni Olluri, propozimin e Vendimit për anulimin kësaj kontrate e kemi bërë në bazë të kontratës të nënshkruar me investitorin. Ishte një pyetje pse nuk kemi fillu me ato kontrata ku investitorët nuk kanë filluar fare me punu unë po ju them se për të gjithë ata kontraktor që nuk kanë përmbush kontratat na do t'i sjellim këtu për shkëputjen e kontratave.

Lulzim Rrustemi, prona komunale është aset i fuqishëm i Komunës së Lipjanit por mjerisht që nuk e kanë shfrytëzu investitorët. Këtu po bëhet një incident se procedura është dashtë të fillohet nga ata që nuk kanë investu fare dhe këtu janë dy investitor që kanë investu dhe është dashtë të bëhet një analizë e investimeve se beteja ligjore për këto është e vështirë dhe mund të shkoj edhe në gjykata ndërkombëtare.

Nazmi Krasniqi, na edhe më herët kemi kërku që të paraqitet një raport për dhënien e pronave në shfrytëzim e sidomos për zonën industriale te ÇMI-ja.

Arban Bahtiri, Komuna në vitin 2006 ka dhënë disa prona kompanive dhe të gjitha ato kompani që nuk i kanë përmbush kontratat unë jam që t'u merren pronat.

Labinot Shahini, nuk e pata ndërmend me diskutu por me shtyri opozita meqë këto vendime i kemi paraqit këtu në bazë të kërkesës së opozitës e tani nuk po mund ta kuptoj se qfarë po don opozita.

Daut Azemi, unë mendoj se ky është Vendimi më i mirë që ka sjellë ekzekutivi dhe besoj se edhe në të ardhmen duhet të vazhdoj me vendime tjera ndaj të gjithë atyre që nuk kanë përmbush kontratat.

Florent Hoxha, unë nuk e di se a po kuptohemi drejt se na e kemi kërku këtë vendim dhe nuk jemi kundër këtij vendimi por po kërkojmë që të hartohet një listë për të gjithë ata që kanë marrë pronat dhe të fillojmë nga ata që nuk kanë bërë asgjë.

Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës, tha se unë po kërkoj nga ju që të na ndihmoni se nuk është e lehtë me i anulë këto kontrata se janë bërë investime të mëdha.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi vuri në votim propozimin e Vendimit me ndryshimet në nenin 2 të Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 8 kundër aprovoi këtë:

VENDIM
PËR SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1NR.464-164 TË DT.01.08.2006 E LIDHUR
NDËRMJET KOMUNËS SË LIPJANIT DHE SHFRYTËZUESIT TË TOKËS NDËRTIMORE
SH.P.K" BEN-AF' ME SELI NË SUHAREKË

Neni 1

Me këtë vendim shkëputet Kontrata 1-464-164 të dt.01.08.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme, e lidhur ndërmjet komunës së Lipjanit e përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës z.Xhevat Olluri dhe ish menaxheri i prokurimit Shemsi Azemi (në tekstin e mëtejshme-Komuna) si dhënës i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore SH.P.K "BEN-AF" përfaqësuar nga Naim Kuqi (në tekstin e mëtejshme-investitori) me seli në Suharekë, për ngastrat kadastrale si në vijim:

P-71409036-00164-20 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 17643m² ,
P-71409036-00166-7 në vendin e quajtur "Branesh" me sipërfaqe prej 12357m² , të evidentuar në Certifikatën nr.4238/2015 ZK Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues SH.P.K BEN-AF.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet shfrytëzuesi i tokës ndërtimore SH.P.K" BEN-AF' që në bazë detyrimeve kontraktore të cekura në par.11.3 të nenit 11 të kontratës 1-464-164 të dt.01.08.2006, që në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të kthen ngastrat kadastrale në gjendjen e mëparshme.

Neni 3

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër, që të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-heqjen e të drejtës së shfrytëzimit nga sh.p.k "Ben-af" të ngastrave kadastrale: P-71409036-00164-20 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 17643m² dhe P-71409036-00166-7 në vendin e quajtur "Branesh" me sipërfaqe prej 12357m² dhe kthimin e tyre në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN (siq ka qenë para dhënies së tokës në shfrytëzim).

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ,Drejtorati i prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim për shkëputjen e kontratës 1nr.463-322 të dt.04.10.2007 e lidhur ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore qendra medicinale "INTERMED" SH.P.K Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi duke praqitur ndryshimet e nenit 2 të Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Blerim Gashi, në këtë rast duhet të bëjmë dallimet meqë dallimet janë substanciale në krahasim me Vendimin e parë. Në arsyetim thuhet se ka paguar lejen e ndërtimit dhe ka bërë shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ka ndërtuar objektin në 4 kate dhe unë jam kundër këtij Vendimi.

Daut Azemi, në këtë rast i ka dhënë një afat shtesë dhe ky investitor nuk ka punuar edhe pas vazhdimit të afatit shtesë. Unë mendoj se këtë Vendim mund ta aprovojmë edhe më lehtë se sa të parin.

Nehat Tërpeza, në kohën kur është marrë ky Vendim unë kam qenë anëtarë i Kuvendit dhe atëherë kemi lloragit se do të realizohet ky qëllim, mirëpo ky investitor nuk kishte qenë serioz se në të njëjtën kohë ka marrë pronë edhe në oborrin e spitalit dhe nuk e ka realizu projektin.

Enver Kozhani, si në Vendimin e parë ashtu edhe në këtë Vendim ne kemi mendimin e njëjtë.

Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës, Drejtori na i tregoi për mashttrimet që na i ka bërë Dalladaku se na dy herë ja kemi marrë pronën dhe ja kemi dhënë por nuk e ka realizuar kontratën e gjithashtu pronën ja kemi dhënë për hapjen e qendrës kardiologjike kurse ai e ka ndërru destinimin.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me propozimin për ndryshimin e nenit 2 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 11 kunder, 1 apstenim aprovoi këtë:

VENDIM

PËR SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1NR.463-322 TË DT.04.10.2007 E LIDHUR NDËRMJET KOMUNËS SË LIPJANIT DHE SHFRYTËZUESIT TË TOKËS NDËRTIMORE QENDRA MEDICINALE "INTERMED" SH.P.K LIPJAN

Neni 1

Me këtë vendim shkëputet Kontrata 1-463-322 të dt.04.10.2007 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme, e lidhur ndërmjet komunës së Lipjanit e përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës z.Xhevat Olluri (në tekstin e mëtejme-Komuna) si dhënësi i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K Lipjan përfaqësuar nga Dr.Fatmir Dalladaku (në tekstin e mëtejme-investitori), për ngastrat kadastrale si në vijim:

P-71409036-00166-3 në vendin e quajtur "Branesh" me sipërfaqe prej 4300m²,
P-71409036-00164-10 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 45700m², të evidentuar në Certifikatën nr.4238/2015 ZK Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues Qendra Medicinale"Intermed" Sh.P.K.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet shfrytëzuesi i tokës ndërtimore Qendra Medicinale"Intermed" Sh.P.K Lipjan që në bazë detyrimeve kontraktore të cekura në nenin 11 par.11.3 të Kontratës 1-463-322 të dt.04.10.2007, që në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike

nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të kthen ngastrat kadastrale në gjendjen e mëparshme.

Neni 3

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër, që të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-heqjen e të drejtës së shfrytëzimit nga Qendra Medicinale "Intermed" Sh.P.K të ngastrave kadastrale: P-71409036-00166-3 në vendin e quajtur "Branesh" me sipërfaqe prej 4300m² dhe P-71409036-00164-10 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 45700m² dhe kthimin e tyre në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN (siq ka qenë para dhënies së tokës në shfrytëzim).

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-r-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shëtesë: Vendimi

VIII

Propozim Vendim për anulimin e Vendimit të Kuvendit komunal Nr.464-264 të datës 23.03.2009 dhe shkëputjen e kontratës së datës 18.09.2009 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës në ZK Banullë -pasuri shoqërore e KK Lipjan, fondacionit të dijanetit të turqisë-institucionet shëndetësore 29 maji

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri,Drejtor i DRKS, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Burbuqe Fazliu, na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, edhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për miratoi këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL NR.464-264 TË DATËS 23.03.2009 DHE SHKËPUTJEN E KONTRATËS SË DATËS 18.09.2009 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË TOKËS NË ZK BANULLË-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, FONDACIONIT TË DIJANETIT TË TURQISË-INSTITUCIONET SHËNDETËSORE 29 MAJI

Neni 1

Me këtë vendim anulohet Vendimi i Kuvendit Komunal Nr.464-264 i datës 23.03.2009 dhe shkëputet Kontrata e datës 18.09.2009 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës-ngastrës kadastrale P-71409003-00926-0 në vendin e quajtur "Rosula"me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 2.80,18 ha në ZK Banullë-pasuri shoqërore e KK Lipjan, Fondacionit të Dijanetit të Turqisë-Institucionet Shëndetësore 29 Maji.

Neni 2

Pas miratimit të këtij propozim-vendimi nga Kuvendi Komunal Lipjan dhe hyrjes së tij në fuqi ngastrat kadastrale me të dhënat e cekura në nenin e mësipërm i kthehet në posedim të plotë Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IX

Propozim Vendim për pagesën e medijëve të Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, hapi shqyrtimin.

Nehat Tërpeza, na si grup parlamentar i LDK-se e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe duke pasur parasysh punën që ka bërë ky Komision na e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, na në parim si PDK e përkrahim këtë propozim Vendim edhe pse kur është formu Komisioni kemi kërku që me një nen të veçantë të atij Vendimi të parashihet pagesa.

Blerim Gashi, edhe na e përkrahim këtë Vendim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota, kundër nuk pati as apstenim nuk pati aprovoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET, Raporti i punës i Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokaliteteve në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Punës i Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit i datës 15.09.2015.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi që çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,⁴⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni